

INFORMATË MBI PLANIN E INTEGRIMIT TË EMIGRANTËVE

Kur të vini për të bërë planin e integrimit, me vete merrni **pasaportën** si dhe të gjitha **dëftesat, diplomat e shkollës** dhe **vërtetimet e punës**.

Plani i integrimit bëhet së bashku me këshilltarin për fuqi puntore/ punonjësin social. Së shpejti me postë do të merrni thirrjen, në të cilën tregohet data dhe koha e takimit.

Në takim mund të bisedojmë psh. për çështjet sa vijojnë:

Shënime personale

- adresa, numri personal dhe shtetësia
- koha aktuale e ardhjes në Finlandë
- madhësia e familjes dhe numri i fëmijëve

Situata momentale jetësore

- gjendja shëndetësore
- hobi, aktivitetet e kohës së lirë
- planet tuaja për integrim në Finlandë

Përvoja e punës dhe studimet

- çfarë ke punuar para se të shpërnguleni në Finlandë
- çfarë ke studiuar
- aftësitë në gjuhën finlandeze

Kërkimi i punës

- çfarë pune do dëshironit të bëni në Finlandë
- a ke nevojë për shkollim tjetër për të gjetur vend pune